

**KËSHTU
MBROHEMI NE.**

Kështu funksionon certifikata e Covid:



Një kod personal QR dokumenton vaksinimin tuaj për Covid19-, për një sëmundje të kaluar ose për një rezultat negativ testi. Dhe kështu mund të mundësojë udhëtimet jashtë shtetit* dhe mund të vihet në përdorim në situata me rrezik në rritje të infektimit.

*Certifikata e Covid nuk është garanci për udhëtimin në shtete të tjera.
Kini parasysh rregullat e destinacionit tuaj të udhëtimit.

**Më shumë për këtë temë:
foph-coronavirus.ch/certificate**



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Confederation

Departamenti Federal i Punëve të Brendshme EDI
Zyra Federale e Shëndetit Publik BAG



COVID Certificate App

Kush mund të marrë një certifikatë të Covid?****

Në mënyrë prapavepruese

E re

PERSON I VAKSINUAR PLOTËSISHT
(vaksinimi përfundimtar bëhet përpara hyrjes në fuqi të certifikatës së Covid në fund të qershorit)

PERSON I VAKSINUAR PLOTËSISHT
(vaksinimi përfundimtar bëhet pas hyrjes në fuqi të certifikatës së Covid në fund të qershorit)

PERSON I SHERUAR
(sëmundja e konfirmuar nëpërmjet një testi PCR)

PERSON ME REZULTAT NEGATIV TESTI

Ku dhe si lëshohet?

Vizitoni faqen e internetit të kantonit në të cilin keni marrë vaksinimin përfundimtar.****

Në varësi nga kantoni, në formë dixhitale ose të printuar nga qendra e vaksinimit, klinika mjekësore, spitali ose farmacia.

Nëpërmjet një formulari në internet të kantonit të banimit. Dërgim i certifikatës në format fizik nëpërmjet postës brenda rreth 7 ditëve.****

Në mënyrë dixhitale në aplikacionin «COVID Certificate» (Certifikata e Covid) (testi PCR) ose nëpërmjet institucionit të testimit në vend (testi i shpejtë i antigenit).**

Për sa kohë është e vlefshme?

365 ditë pas dhënies së dozës së fundit të vaksinës (COVID-19 Vaccine Janssen: 365 ditë duke filluar nga dita e 22-të pas dozës së vaksinës).***

Vlefshmëria e certifikatës fillon në ditën e 11-të pas rezultatit të testit pozitiv PCR dhe zgjat 180 ditë pas rezultatit të testit.***

Testi PCR: 72 orë nga momenti i marrjes së kampionit. Testi i shpejtë i antigenit: 48 orë nga momenti i marrjes së kampionit.***

Çfarë duhet pasur parasysh?

Gjatë kontrollit duhet paraqitur një dokument identifikimi me fotografi (p.sh. ID).

Si do të përdoret?

Tregoni të printuar kodin QR të certifikatës suaj të Covid, në mënyrë dixhitale ose në aplikacion, nëse duhet të identifikoheni

**Më shumë për këtë temë:
foph-coronavirus.ch/certificate**

** Për vetëtestim nuk lëshohet asnjë certifikatë e Covid

*** Versioni i datës 11.10.2021, kohëzgjatja e vlefshmërisë në Zvicër, ndryshimet të rezervuara

**** Për personat e vaksinuar jashtë shtetit vlejné kushte të tjera paraprake për të marrë certifikatën e Covid.

Për më shumë informacione: bag.admin.ch/howtoget-covidcertificate

Aplikacioni «COVID Certificate»
(Certifikata e Covid) mund të shkarkohet falas.



COVID Certificate App